



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE**

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR TRAJNERË AFATGJATË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon të kontraktojë 39 trajnerë afatgjatë, për dhënie trajnimi për administratën zgjedhore dhe disa aktorë të tjerë për zgjedhje. Numri i qendrave të votimit të cituara në vijim janë mbështetur në të dhënat aktuale të qendrave të votimit në shkallë vendi për secilën bashki. Çdo ndryshim i mundshëm i qendrave të votimit do të reflektohet në planin e punës të secilit trajnues.

**NEVOJAT E KQZ PËR TRAJNERË AFATGJATË**

**Qarku Shkodër, 3 trajnerë**

1. Bashkia Malësi e Madhe, 1 trajner  
Trajneri nr. 1 do të trajnojë KZAZ nr. 1 dhe do të trajnojë 72 QV;
2. Bashkia Shkodër, 1 trajner  
Trajneri nr. 2 do të trajnojë KZAZ-të nr. 2, 3, 4, 5, 6 dhe do të trajnojë 70 QV;
3. Bashkia Pukë dhe Fushë Arrëz, 1 trajner  
Trajneri nr. 3 për KZAZ-të nr. 7, 8 dhe do të trajnojë 36 QV;

**Qarku Kukës, 2 trajnerë**

1. Bashkia Tropojë, 1 trajner  
Trajneri nr. 4 do të trajnojë KZAZ nr. 9 dhe do të trajnojë 40 QV
2. Bashkia Kukës dhe Has, 1 trajner  
Trajneri nr. 5 për KZAZ-të nr. 10, 11 dhe do të trajnojë 39 QV

**Qarku Lezhë, 2 trajnerë**

1. Bashkia Lezhë dhe Kurbin, 1 trajner  
Trajneri nr. 6 do të trajnojë KZAZ nr. 12, 13, 14 dhe do të trajnojë 58 QV
2. Bashkia Mirditë, 1 trajner  
Trajneri nr. 7 do të trajnojë KZAZ-të nr. 15 dhe do të trajnojë 49 QV

**Qarku Dibër, 3 trajnerë**

1. Bashkia Mat dhe Klos, 1 trajner  
Trajneri nr. 8 do të trajnojë KZAZ-të nr. 16, 17 dhe do të trajnojë 38 QV
2. Bashkia Bulqizë, 1 trajner  
Trajneri nr. 9 do të trajnojë KZAZ nr. 18 dhe do të trajnojë 28 QV
3. Bashkia Dibër, 1 trajner  
Trajneri nr. 10 do të trajnojë KZAZ nr. 19 dhe do të trajnojë 51 QV

### **Qarku Durrës, 3 trajnerë**

1. Bashkia Krujë, 1 trajner  
Trajneri nr. 11 do të trajnojë KZAZ nr. 20 dhe do të trajnojë 92 QV
2. Bashkia Durrës, 1 trajner  
Trajneri nr. 12 do të trajnojë KZAZ-të nr. 21, 22, 23, 24 dhe do të trajnojë 82 QV
3. Bashkia Shijak, 1 trajner  
Trajneri nr. 13 do të trajnojë KZAZ nr. 25 dhe do të trajnojë 54 QV

### **Qarku Tiranë, 5 trajnerë**

1. Bashkia Vorë dhe Kamëz, 1 trajner  
Trajneri nr. 14 do të trajnojë KZAZ-të nr. 26, 27, 28, 29 dhe do të trajnojë 132 QV
2. Bashkia Tiranë, 3 trajnerë  
Trajneri nr. 15 do të trajnojë KZAZ-të nr. 30, 31, 32 dhe do të trajnojë 144 QV  
Trajneri nr. 16 do të trajnojë KZAZ-të nr. 33, 34, 35, 36, 37 dhe do të trajnojë 95 QV  
Trajneri nr. 17 do të trajnojë KZAZ-të nr. 38, 39, 40, 41 dhe do të trajnojë 121 QV
3. Bashkia Kavajë dhe Rrogozhinë, 1 trajner  
Trajneri nr. 18 do të trajnojë KZAZ-të nr. 42, 43 dhe do të trajnojë 143 QV

### **Qarku Elbasan, 5 trajnerë**

1. Bashkia Peqin dhe Belsh, 1 trajner  
Trajneri nr. 19 do të trajnojë KZAZ-të nr. 44, 45 dhe do të trajnojë 48 QV
2. Bashkia Elbasan dhe Cërrik, 2 trajnerë  
Trajneri nr. 20 do të trajnojë KZAZ-të nr. 46, 47, 48 dhe do të trajnojë 77 QV  
Trajneri nr. 21 do të trajnojë KZAZ-të nr. 49, 50 dhe do të trajnojë 39 QV
3. Bashkia Gramsh, 1 trajner  
Trajneri nr. 22 do të trajnojë KZAZ nr. 51 dhe do të trajnojë 49 QV
4. Bashkia Librazhd dhe Prrenjas, 1 trajner  
Trajneri nr. 23 do të trajnojë KZAZ-të nr. 52, 53 dhe do të trajnojë 55 QV

### **Qarku Fier, 4 trajnerë**

1. Bashkia Lushnje dhe Divjakë, 1 trajner  
Trajneri nr. 24 do të trajnojë KZAZ-të nr. 54, 55, 56 dhe do të trajnojë 92 QV
2. Bashkia Fier, 1 trajner  
Trajneri nr. 25 do të trajnojë KZAZ-të nr. 57, 58, 59 dhe do të trajnojë 63 QV
3. Bashkia Patos dhe Rroskovec, 1 trajner  
Trajneri nr. 26 do të trajnojë KZAZ-të nr. 60 dhe 61, do të trajnojë 82 QV
4. Bashkia Mallakastër, 1 trajner  
Trajneri nr. 27 do të trajnojë KZAZ nr. 62, do të trajnojë 52 QV

### **Qarku Berat, 3 trajnerë**

1. Bashkia Dimal dhe Kuçovë, 1 trajner  
Trajneri nr. 28 do të trajnojë KZAZ-të nr. 63, 64 dhe do të trajnojë 65 QV
2. Bashkia Berat, 1 trajner  
Trajneri nr. 29 do të trajnojë KZAZ-të nr. 65, 66 dhe do të trajnojë 74 QV
3. Bashkia Skrapar dhe Poliçan, 1 trajner  
Trajneri nr. 30 do të trajnojë KZAZ-të nr. 67, 68 dhe do të trajnojë 23 QV

### **Qarku Korçë, 3 trajnerë**

1. Bashkia Pogradec, Maliq dhe Pustec, 1 trajner  
Trajneri nr. 31 do të trajnojë KZAZ-të nr. 69, 70, 71 dhe do të trajnojë 94 QV
2. Bashkia Korçë dhe Devoll, 1 trajner  
Trajneri nr. 32 do të trajnojë KZAZ-të nr. 72, 73, 74 dhe do të trajnojë 103 QV
3. Bashkia Kolonjë, 1 trajner  
Trajneri nr. 33 do të trajnojë KZAZ nr. 75 dhe do të trajnojë 29 QV

### **Qarku Gjirokastrë, 3 trajnerë**

1. Bashkia Përmet dhe Këlcyrë, 1 trajner  
Trajneri nr. 34 do të trajnojë KZAZ-të nr. 76, 77 dhe do të trajnojë 24 QV
2. Bashkia Tepelenë dhe Memaliaj, 1 trajner  
Trajneri nr. 35 do të trajnojë KZAZ-të nr. 78, 79 dhe do të trajnojë 23 QV
3. Bashkia Gjirokastrë, Libohovë dhe Dropull, 1 trajner  
Trajneri nr. 36 do të trajnojë KZAZ-të nr. 80, 81, 82 dhe do të trajnojë 69 QV

### **Qarku Vlorë, 3 trajnerë**

1. Bashkia Vlorë dhe Selenicë, 1 trajner  
Trajneri nr. 37 do të trajnojë KZAZ-të nr. 83, 84, 85, 86, 87 dhe do të trajnojë 93 QV
2. Bashkia Himarë, 1 trajner  
Trajneri nr. 38 do të trajnojë KZAZ-të nr. 88 dhe do të trajnojë 36 QV
3. Bashkia Sarandë, Delvinë, Finiq dhe Konispol, 1 trajner  
Trajneri nr. 39 do të trajnojë KZAZ-të nr. 89, 90, 91, 92 dhe do të trajnojë 76 QV

## **PËRSHKRIMI I DETYRAVE KRYESORE TË TRAJNERIT**

- ✓ Trajnim i administratës zgjedhore, monitoruesve të fushatës zgjedhore, Operatorëve PEI apo PEVN, sipas përcaktimeve dhe kalendarëve të KQZ;
- ✓ Monitorim i performancës së administratës zgjedhore që trajnon dhe të qendrave të votimit vetëm me kërkesë të KQZ
- ✓ Planifikim të trajnimeve dhe aftësi kordinuese për realizimin e tyre
- ✓ Praktikon metoda të trajnimit që sigurojnë përfshirjen aktive të gjithë pjesëmarrësve në trajnim;
- ✓ Aftësi për të udhëhequr diskutimet duke ruajtur klimën pozitive;
- ✓ Ofron udhëzime të qarta në procedurat dhe aktivitetet gjatë seancave të trajnimit, për arritjen e rezultateve të moduleve të trajnimit;
- ✓ Përdorimi i TIK për të vizualizuar përmbajtjen e moduleve;
- ✓ Dokumenton dhe raporton për zhvillimin e trajnimeve, sipas kërkesave të KQZ-së.
- ✓ Dokumenton dhe raporton për parregullsitë e verejtura gjatë ushtrimit të detyrave të administratës zgjedhore në zonën e tij të trajnimit/ monitorimi;

## **KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË APLIKANTËT:**

1. Kriteret që duhet të përmbushë kandidati që aplikon për trajner afatgjatë për zgjedhje, janë:
  - a) formimi universitar i ciklit të parë apo të dytë sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në fushën e përcaktuar në njoftimin për shprehjen e interesit të publikuar nga KQZ në faqen zyrtare të saj;
  - b) përvojë në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë apo në institucionet parauniversitare të arsimit parauniversitar, apo i angazhuar si trajner nga organizatat e njohura vendase apo ndërkombëtare, mundësisht me një eksperiencë si trajner në proceset zgjedhore të mëparshme;
  - c) Të jetë i paangazhuar në struktura drejtuese qendrore e vendore të partive politike dhe të mos ketë patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti

zgjedhor;

- d) Të mos jetë në detyrë në strukturat e organeve të Policisë së Shtetit, Policisë gjyqësore, Gardës së Republikës, inspektoriat qendror apo lokal, ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura, punonjës i Shërbimit Informativ, organeve të pushtetit gjyqësor;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- f) Të mos jetë i dënuar administrativisht për shkelje të dispozitave, të cilat lidhen me zgjedhjet, apo të mos ketë masë disiplinore në fuqi në shërbimin civil;
- g) Preferohen kandidatët të cilët janë banorë të bashkisë/njësisë administrative në të cilën aplikojnë.

Aplikimi:

Afati fillestar që aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin është data 22.11.2024.

Aplikimet të bëhen online në linkun bashkëlidhur:

<https://forms.office.com/e/hcZqXpQDR3>

### **DOKUMENTACIONI:**

1. Kërkesë e nënshkruar e aplikantit në të cilën përcakton edhe qarkun/bashkinë përkatëse për të cilin aplikon;
2. Kopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti/pasaportë);
3. Jetëshkrim (CV) e përditësuar, ku të pasqyrohet adresa e postës elektronike dhe numri telefonik i kontaktit;
4. Diplomë e arsimit të lartë (e noterizuar);
5. Kopje e librezës së punës (e noterizuar);
6. Çertifikatë personale të lëshuar nga portali e-albania;
7. Çertifikatë kualifikimi, trajnimi ose dokument tjetër, që vërteton eksperiencën si trajner (nëse ka);
8. Vetëdeklarimin e nënshkruar sipas modelit bashkëlidhur.
9. Aplikantët e punësuar duhet të dorëzojnë edhe lejen nga titullari i institucionit për lejimin e tij në kryerjen e kësaj veprimtarie për periudhën e kërkuar

Aplikantët të cilët kanë qenë të përfshirë si trajnerë të KQZ në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023 nuk është e nevojshme të noterizojnë diplomën e arsimit të lartë apo librezën e punës.

KQZ brenda shtatë ditëve nga afati i fundit të dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët, pas vlerësimit të aplikimeve, njofton aplikantët e kualifikuar për fillimin e trajnimit të tyre.

#### a. Vlerësimi i aplikimeve

- i. Vlerësim i kriterëve përmes dokumentacionit. Kualifikohen në këtë fazë të gjithë kandidatët që përmbushin kriteret dhe kanë dokumentacionin e plotë.
- ii. Të gjitha dosjet/aplikimet e kualifikuara në fazën e parë, pikëzohen dhe rankohen nga kandidati me më shumë pikë dhe vijuar me rend zbritës, të ndarë për çdo bashki.
- iii. Njoftohen elektronikisht për trajnim nga KQZ, kandidatët e rankuar deri kufirin 5% mbi numrin e nevojshëm që do të angazhohen në procesin zgjedhor

#### b. Përzgjedhja e trajnerëve

- i. KQZ organizon një trajnim 1 ditor në mjediset e KQZ sipas një kalendari të hartuar prej saj me ndarjen e tyre në grupe.
  - ii. Në përfundim të trajnimit, kandidatët zhvillojnë testimin dhe kalimi me sukses i këtij testimi i konsideron ata trajnerë.
  - iii. Trajnimi dhe testimi konsiston në vlerësimin e tyre për cilësitë e tyre si trajner, aftësitë e tyre teknologjike.
- c. Certifikimi i trajnerëve
- i. Trajnerët e përzgjedhur kryejnë trajnimin 8 ditor me qëllim certifikimin e tyre
  - ii. Trajnerët certifikohen për secilën nga kurrikulat e mëposhtme:
    - Administratën zgjedhore (KZAZ)
    - Administratën zgjedhore (GNV)
    - Administratën zgjedhore (KQV)
    - Operatorët PEI
    - Operatorët PEVN
    - Monitoruesit e fushatës zgjedhore
  - iii. Pjesëmarrja e rregullt në trajnim është e detyrueshme. Për këtë KQZ lidh kontratë me secilin prej trajnerëve të përzgjedhur. Pagesa e tyre fillon që prej lidhjes së kontratës.
- d. Kohëzgjatja e trajnimit në çdo ditë është 6 orë në ditë
- e. Vendi i zhvillimit të trajnimit: njoftohet nga KQZ (Tiranë/Durrës)
- f. Vlerësimi i trajnimit: 70 pikë për aktivizimin e trajnerëve, prezantimet dhe punët e kryera dhe me 30 pikë për testimin me shkrim.
- g. Trajnimi konsiderohet i kaluar me sukses kur kandidati vlerësohet me së paku 70% të pikëve për aktivizimin e tyre, prezantimet dhe punët e kryera si dhe 50% të pikëve të testimit me shkrim. Trajnerët që kalojnë më sukses trajnimin konsiderohen trajnerë të certifikuar, bëhen pjesë e bazës së të dhënave në KQZ.
- h. Sektori i dokumentacionit zgjedhor dhe trajnimeve, duke respektuar renditjen, komunikon me trajnerët përkatës, sipas nevojës për trajnerë/për bashki dhe i njofton ata për të nënshkruar kontratën e shërbimit si trajnerë të certifikuar.

Detajet e angazhimit të tyre, pagesës sipas ngarkesës dhe detyrimeve të tjera përcaktohen në kontratën që KQZ do të lidhë me trajnerët.